

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 14.05.2017]

Për: Operatorin Ekonomik “Shpresa - AL” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksion i hyrjes së qytetit Bajram Curri”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i hyrjes së qytetit Bajram Curri”**.

Kohëzgjatja: brënda 7 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 45.392.000 (dyzet e pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar për vitin 2017 është 9.566.666 (nëntë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 24.03.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

Nr	Shoqëria	Oferta lek pa tvsh para kontrollit aritmetik
1	Florida shpk & Radika shpk	30,058,329
2	Halili 1 shpk & Shendelli shpk	32,636,693
3	Vllaznimi shpk & Company Riviera 2008 shpk	33,841,962

4	Shpresa – AL shpk	34,494,101
5	MELA shpk & Alb Shpresa shpk	36,000,000
6	Boshnjaku B shpk	37,278,004
7	Kacdedja shpk	37,676,504
8	PE-VLA-KU shpk	38,159,500
9	LALA shpk & Jody Company shpk & Shansi Invest shpk	40,852,799
10	Sireta 2F shpk	42,222,222
11	Kevin Konstruktion shpk	43,023,878
12	Adem Pojani	Nuk ka paraqitur oferte

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Florida” shpk (68.14%), dhe “Radika” shpk (31.86%) per arsye se:

Shoqeria “Florida” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Sistemim – asfaltim lagja 28 gushti” me vlere 15.466.912 leke pa tvsh. Kjo pune nuk eshte e mjaftueshme per plotesimin e kriterit per kualifikim pasi bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper, duke qene se kjo shoqeri ka marre persiper perqindjen me te madhe te punimeve, vlere per nje objekt te vetem duhet te ishte sa 50% i fondit limit ose 22.696.000 leke pa tvsh.

Shoqeria “Florida” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin, pasi sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper te kryeje punime elektrike dhe nuk ka ta punesuar inxhinier elektrik.

Shoqeria “Florida” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses, pasi sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper te kryeje punime elektrike dhe nuk ka piken e kerkuar te licenses NP.11.

Shoqeria “Radika” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise pasi nuk ka paraqitur licensen e kerkuar ne kriterin per kualifikim.

2. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Halili 1” shpk (20.58%), dhe “Shendelli” shpk (79.42%) per arsye se:

Shoqeria “Halili” shpk nuk ploteson kerkesen e pergjithshme per kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve fiskale pasi ka paraqitur vertetim nr. 478 prot, date 21.03.2017 nga DRT Kukes ku rezulton se deri ne daten 21.03.2017 ka detyrime tatimore te papaguara dhe eshte ne akt-marreveshje me sektorin e borxhit.

Shoqeria “Halili” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike pasi ne vertetimin e paraqitur nuk perfshihet shlyerja e detyrimeve per muajin janar 2017, muaj i maturuar ne daten 24.03.2017, ditën e hapjes se ofertave.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Vllaznimi” shpk (58%), dhe “Company Riviera 2008” shpk (42%) per arsye se:

Shoqeria “Vllaznimi” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri.

Referuar deklarates se puneve ne proces rezulton se shoqeria “Company Riviera 2008” shpk ka ne proces pune me nje vlere te pergjithshme prej 229.425.750 leke pa tvsh. Keto pune konsistojne ne rivitalizime urbane dhe rikonstruksione rruges. Per kontraten qe prokurohet shoqerise “Company Riviera 2008” shpk i takon te kryeje nje volum punimesh prej 19.064.640 lekesh pa tvsh. Vlera totale e punimeve qe duhet te kryeje shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nese shpallet fituese e kontrates qe shqyrtohet eshte 248.490.390 leke, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4C e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 100.000.000 leke. Ne daten 04.04.2017 KVO i dergoi nje kerkese ku kerkohet informacion per punet e deklaruar ne proces. Kjo shoqeri deri ditën e sotme nuk ka derguar asnje pergjigje. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Rrogozhine nga data 28.09.2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

4. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Mela” shpk dhe “Albshpresa” shpk per arsye se:

Shoqeria “Mela” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi ka marre persiper punime shtresash rrugore dhe nuk ka piken e licenses NS18 (punime topogjeodezike).

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

5. Te skualifikoje shoqerine “Boshnjaku B” shpk per arsye se:

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

6. Te skualifikoje shoqerine “Kacdedja” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa objekteve me vlere totale te realizuar ne tre vitet e fundit 29.643.878 leke nga 90.784.000 leke qe duhet te ishte per te permbushur kushtin. Objekti ndertim shkolle nuk eshte llogaritur pasi nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme.

7. Te skualifikoje shoqerine “Adem Pojani” pasi nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Shpresa - AL” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **34.494.101 (tridhjetë e kater milion e katerqind e nentëdhjetë e kater mije e njeqind e nje)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **24.04.2017**.

Ne daten 28.04.2017 paraqiti ankim shoqeria “Florida” shpk. Shoqerise ju kthye pergjigje ne daten 02.05.2017 duke e refuzuar ankimin.

Ankime te tjera nuk jane paraqitur.